

URDHËR
Nr. 79, datë 17.4.2026

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2025, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar; dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm të Gjendjes Civile, znj. Enkelejda Shpuza, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Standardizimit të Shërbimeve të Gjendjes Civile.
2. Kompetencat e deleguara, sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Gjendjes Civile.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Enkelejda Shpuza dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
4. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari